



Datë: 15.07.2025
Numër Protokolli: 4795/2025

A.nr.1076/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1076/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi D.K, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike *“kërkesë nga marrëdhënia e punës”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafët 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1076/2025, e datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesi D.K, ashtu që **detyrohet** Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e datës 28.04.2025 të parashtruar nga ankuesi dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi D.K (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 04.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kompensimit për punë me vëllim të shtuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (*tutje MINT*), ndërsa kjo e fundit më datë 27.06.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3779/2025 të datës 04.06.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 28.05.2025 nga V.L për ankuesin; Emailin e datës 29.05.2025 nga L.Zh për ankuesin; Emailin e datës 21.05.2025 nga A.J; Emailin e datës 04.03.2024 nga F.R për A.H; Emailin e datës 04.03.2025 nga F.R për Q.A dhe A.J; Emailin e datës 27.02.2025 nga Q.J për G.Z, Xh.G, F.R dhe B.I; Emailin e datës 19.12.2024 nga A.K për ankuesin; Emailin e datës 30.05.2025 nga F.D për ankuesin; Emailin e datës 29./05.2025 nga F.D për S.Z; Emailin e datës 27.05.2025 nga S.Z për F.D dhe ankuesin; Kërkesën përmes emailit e datës 28.04.2025 nga ankuesin për S.Z; Emailin e datës 215.11.2024 nga E.Z për ankuesin; Emailin e datës 06.12.2024 nga A.B për ankuesin; Emailin e datës 06.12.2024 nga I.D për V.R-V, A.B. B.K; Emailin e datës 20.12.2024 nga E.K për ankuesin; Emailin e datës 28.05.2025 nga D.K për ankuesin; Emailin e datës 05.05.2025 nga A.H për M.P dhe ankuesin; Emailin e datës 11.03.2025 nga MP për A.B; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 27.06.2025; Akt Emërimit me Nr. 03/2024 të datës 03.05.2024; Përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative; Listën e pagave për ankuesin 01.01.2024 deri 30.06.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshilli, ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr.03.2024 të datës 03.05.2024, mban pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.

Tutje sipas emailit të datës 25.11.2024 të dërguar nga Zyra e Sekretares së Përgjithshme të MINT, për ankuesin, thuhet se: më kërkesë të u.d Sekretares së Përgjithshme ju njoftojmë se deri në një vendim tjetër jeni përgjegjës për kryerjen e detyrave të Teknologjisë Informative në MINT, dhe urgjentisht të merreni me rregullimin e internetit në zyrën e Departamentit Ligjor dhe DRSJM.

Ankuesi më datë 28.04.2025 përmes emailit, ju është drejtuar U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT, duke kërkuar që meqë është i angazhuar nga data 25.11.2024 në punë shtesë përkatës si person përgjegjës në fushën e Teknologjisë Informative në MINT, atëherë përkundër angazhimit të vazhdueshëm nuk ka përfituar kompensim prej 20% sipas Rregullores Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuar në Sektorin Publik, e njëkohësisht ka kërkuar që zhvillimin e procedurave lidhur me kompensimin sipas rregullores. U.D Sekretarja e Përgjithshme e MINT , më datë 27.05.2025 përmes emailit të dërguar për znj. F.D dhe ankuesin thekson se aktualisht në nivel të ministrisë nuk kemi të angazhuar asnjë zyrtar të IT-së konsiderohet e domosdoshme që kjo nevojë të mbulohet përmes angazhimit të zyrtarit nga ARBK, D.K, sepse është kërkesë e domosdoshme për funksionimin e rregullt të shërbimeve teknologjike brena ministrisë, ndërsa znj. F.D përmes emailit të datës përmes emailit të datës 29.05.2025 ka njoftuar u.d Sekretaren e Përgjithshme të MINT se nuk kemi njohuri për nënshkrim të marrëveshjes nga ana e ZKS-së dhe z. D.K si dhe po ashtu siç e përcakton rregullorja në fuqi kërkesa për kompensim retro nuk mund të bëhet.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër faktit që jam caktuar të mbulojë një pozitë të plotë institucioni nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për kompensim sipas Rregullores Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuar në Sektorin Publik edhe përkundër faktit që të gjitha detyrat janë përfunduar sipas kërkesave. Kërkon që të aprovet ankesa. të obligohet MINT që të procedon pagesën në përputhje me dispozitat ligjore, nga data 25.11.2024 dhe të obligohet Thesari të bëjë këtë ekzekutim në mënyrë retroaktive.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure*. 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën e datës 28.04.2025, të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të shqyrtoj kërkesat e ankuesit dhe të nxjerrë akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo brenda afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, përgjigja e datës 27.05.2025 e u.d Sekretares së Përgjithshme të MINT, në raport me kërkesat e parashtruara përmes 28.04.2025, cenojnë të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjen në mënyrë meritore, ngase, ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi pretendon në realizimin e disa të drejtave të cilat mendon se janë duke ju mohuar, apo shkelur, e që nënkupton kompensimin për vëllim në punë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, kështu që përkitazi me këtë Sekretarja e Përgjithshme e MINT, është e obliguar të shqyrtoj kërkesën e datës 28.04.2025, të ankuesit, duhet të nxjerr akt administrativ në raport me kërkesën e tij, të veproj në pajtim me parimet e përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe parimet e përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që në kuptim të kësaj Kolegji i Këshillit, ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar vetëm në kuptim të shkeljeve procedurale.

Kështu që, thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.1076/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit D.K;
- Organit të Punësimit: Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të MINT dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.